

VENDIM
Nr.337, datë 16.4.1996

PËR FORCIMIN E KONTROLLIT NË NDRYSHIMET E RIKONSTRUKSIONET E
AMBIENTEVE NË NDËRTESAT EKZISTUESE NË BASHKËPRONËSI

Me propozimin e Ministrit të Ndërtimit dhe Turizmit dhe Sekretariatit Shtetëror të Pushtetit Lokal, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Personat fizikë e juridikë shtetërorë ose privatë, vendas e të huaj, për ndryshime e rikonstruksione të ambienteve në ndërtesat ekzistuese në bashkëpronësi, marrin leje ndërtimi nga Këshilli i Rregullimit të Territorit (KRT) i rrethit.

2. Procedurat për marrjen e lejes së ndërtimit bëhen sipas përcaktimeve në ligjin nr.7693, datë 26.4.1993 “Për urbanistikën” si dhe ligjit nr.8015, datë 19.10.1995. Në rastet e ndërhyrjeve në elementet strukturoire mbajtëse, dokumenteve i bashkëngjitet edhe miratimi i bashkëpronarëve në përputhje me dispozitat e Kodit Civil mbi bashkëpronësinë në ndërtesa.

3. Zyra e urbanistikës e rrethit dërgon në Policinë e Ndërtimit kopje të vendimeve të marra nga KRRT-ja e rrethit për lejet e ndërtimit të miratuara për ndryshimet e rikonstruksione në ambientet e ndërtesave në bashkëpronësi.

4. Zyra e urbanistikës në bashki e komuna kontrollon ndryshim e rikonstruksion të ambienteve në ndërtesat ekzistuese në bashkëpronësi.

Kur konstaton ndryshime e rikonstruksione pa leje të KRRT-së zbatohen sanksionet parashikuara në nenet 41 dhe 61 të ligjit për urbanistikën, bën pezullimin e punimeve, bën denoncimin në organet e policisë së rendit dhe, sipas rastit, kur shkelja përbën vepër penale bëhet denoncimi në gjykatë.

5. Policia e ndërtimit kontrollon ndryshimet dhe rikonstruksionet në fazë e zbatimit të projekteve dhe merr masat në përputhje me ligjin për policinë e ndërtimit.

Kur konstaton ndërtime të këtij lloji pa leje ndërtimi, kërkon menjëherë pezullimin e ndërtimit dhe paraqet me shkrim kërkesën në zyrën e urbanistikës të bashkisë apo komunës për të ndërhyrë sipas pikës 4 të këtij vendimi.

6.

Në raste të denoncimeve nga persona që kanë konstatuar ndryshime e rikonstruksione që përbëjnë shkelje të këtij vendimi, në zyrat e urbanistikës në bashki e komuna ose në policinë e Ndërtimit, këto të fundit brenda 24 orëve bëjnë veprifikimin dhe ndërhyjnë në marrjen e masave përkatëse sipas pikave 4 e 5 të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi